

KATALOG

“BLERJE MATERIALESH TË

NDRYSHME PËR PASTRIM”

(I PËRDITËSUAR)

17.06.2025

PËRMBAJTJA

1. Fjalor i termave	Faqe 3-4
2. Hyrja	Faqe 5
3. Të dhëna teknike të përgjithshme	Faqe 6
4. Llojet e materialeve të pastrimit	Faqe 7-10
5. Ambalazhimi dhe Etiketimi	Faqe 11
6. Artikujt dhe specifikimet teknike të tyre	Faqe 12
6.1. “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”	Faqe 12-16
6.2. “Blerje materiale për pastrim”	Faqe 17-21
7. Tabela me çmimet e unifikuara për çdo artikull	Faqe 22-27

Shënim: Duke konsideruar problematikat e procedurës së Prokurimit nga OBP konkretisht Loti 1 me objekt: "Blerje materiale për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim", për çmimet e disa artikujve që përfshihen në këtë katalog, si dhe disa kërkesa për sqarim të ardhura për këto të fundit, grupi i punës ka kryer ritestim tregu për 5 artikujt: *Insekticid për bletë/miza/milingona, Malathion, Rodenticid, K-othrine (ose ekuivalent), Solucion mizash dhe mushkonjash spray (ambalazh 500 ml).*

1. FJALORI I TERMAVE

AMBALAZH→ një ose më shumë mbajtës dhe çdo komponent apo material tjetër i nevojshëm që mbajtësi të kryejë funksionet e tij dhe funksione të tjera të sigurisë.

DEZINFEKTANT→ janë biocide ose produkte që i shkatërrojnë mikroorganizmat ose e ndalojnë rritjen, zhvillimin dhe shumimin e tyre si dhe përdoren për mënjanimin e patogjenëve nga rrethi jetësorë, nga lëndët të ndryshme. Përpara trajtimit është e rëndësishme që sipërfaqja të pastrohet.

KLORI→ është mjet i fortë baktericid, me veti të forta oksiduese. Përdoret për dezinfektimin e lëndëve të ndryshme, hapësira, sipërfaqe të ndryshme dhe ujë. Klori elementar përdoret për përfitimin e mjeteve të tjera dezinfektuese me bazë të klorit (ujë klori, klorur gëlqeror, hipoklorit kalciumi, kloramin T, dikloramin T). Aftësia për dezinfektimin e këtyre mjeteve rrjedh nga klori prezent aktiv. Përqendrimi i lëndës aktive në klor (Hipoklorit Natriumi) përcakton qëlimin dhe fushën e përdorimit.

DETERGJENT→ është çdo substancë ose preparat, në formë të lëngët, pluhuri, paste, kallëpi, blloku, figure etj., që përmban sapun dhe/ose lëndë të tjera tensioaktive, i destinuar për t'u përdorur në proceset e larjes dhe të pastrimit, si dhe tregtohen dhe/ose përdoren për qëllime shtëpiake ose industriale.

Detergjentë vlerësohen edhe produktet e mëposhtme:

- a) "Preparat ndihmës për larje", i përcaktuar për njomje (paralarje), shpëlarje ose zbardhje rrobash, tekstilësh për përdorim shtëpiak etj.;
- b) "Zbutës tekstilësh", i përcaktuar për të ndryshuar karakteristikat në prekje të tekstileve, në proceset që plotësojnë larjen e tyre;
- c) "Preparat pastrimi", i përcaktuar për pastruesit shtëpiakë, universalë dhe/ose pastrime të tjera sipërfaqesh.

pH→ është masë e përqendrimit të joneve hidrogjen në tretje, që shprehin aciditet apo alkalinitet. Kur pH është nga 1-6, tretësira është acide, kur vlera e tij është 7 atëherë është neutrale dhe kur vlera e tij është 8-14 atëherë tretësira është bazike.

VISKOZITETI→ veti e lëndës që paraqet një rezistencë gjatë rrjedhjes për shkak të fërkimit të brendshëm të shtresave të ndryshme ndaj shformimit me një shkallë të caktuar.

ORGANOFOSFAT/fosfor organik→ Kimikate që gjenden në insekticide të cilët japin rezultat duke sulmuar sistemin nervor të insekteve.

HOMOGJENE→ Përzierje ku elementët përbërës janë të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme, dhe ku vetëm një fazë (e lëngshme, e ngurtë ose e gaztë) dallohet.

SOLUCION→ Përzierje e lëngshme ku lënda e tretshme shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme në përbërësin kryesor, tretësin.

LËNDË TENSIOAKTIVE→ është çdo substancë organike dhe/ose preparat, i përdorur në detergjentë, i cili vepron në sipërfaqe dhe përbëhet nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe një a më shumë grupe hidrofobe, të një natyre dhe me përmasa të tilla, që i japin aftësinë të zvogëlojë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër, të formojë emulsione dhe/ose mikroemulsione dhe/ose micela dhe të thithë në sipërfaqet e kontaktit ujë-trup i ngurtë.

I BIODEGRADUESHËM/SHPËRBËRJE→ "Biodegradim" është një proces, prej të cilit përbërjet kimike organike (përbërjet që përmbajnë karbon) zbërthehen në përbërje më të thjeshta kimike nën veprimin e mikroorganizmave në natyrë.

PRODUKT→ është çdo substancë, artikull i fabrikuar ose send jo ushqimor, që mund të jetë i ri, i përdorur apo i riparuar, i parashikuar për t'u përdorur nga konsumatorët ose që mund të përdoret prej tyre në kushte të arsyeshme e të parashikueshme edhe kur nuk është i parashikuar për ta, dhe që furnizohet ose bëhet i disponueshëm gjatë një veprimtarie tregtare.

Këtu përfshihet edhe produkti që i furnizohet apo i bëhet i disponueshëm konsumatorit në kontekstin e ofrimit të një shërbimi nga ofruesit e shërbimit, kur ky produkt përdoret nga konsumatori.

PRODUKT I SIGURT→ është çdo produkt për konsumatorin, i cili, në kushte normale ose të arsyeshme, të parashikueshme përdorimi, përfshirë kohëzgjatjen dhe, sipas rastit, kërkesat për vënien në shërbim, për instalimin e për mirëmbajtjen, nuk paraqet ndonjë rrezik ose vetëm një shkallë minimale rreziku, të pajtueshëm me përdorimin e produktit, që vlerësohet i pranueshëm dhe në përputhje me nivelin e lartë të mbrojtjes e të sigurisë së individëve.

PRODUKT I RREZIKSHËM→ është çdo produkt, i cili nuk është në përputhje me përkufizimin e termit "produkt i sigurt".

2. HYRJE

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sha, në zbatim të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në zbatim të nenit 13 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.” për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, ka hartuar katalogun me specifikimet teknike dhe çmimet e unifikuara për objektin e prokurimit “Blerje materiale të ndryshme për pastrim”.

Në gërmën “d”, të pikës 11, të VKM-së nr 531 datë 7.9.2023 është përcaktuar: “Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si: ... d) blerje materiale të ndryshme për pastrim.

3. TË DHËNA TEKNIKE TË PËRGJITHSHME

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, e konkretisht:

- Ligji nr. 10216, datë 21.1.2010 “Për detergjentet”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, i ndryshuar.

Produktet duhet të jenë të sigurta, në kushte normale ose të arsyeshme, përfshirë kohëzgjatjen sipas rastit dhe kërkesat për vendosjen në treg.

Produktet duhet të jenë të paketuara me materiale të riciklueshme ose të kompostueshme, duke minimizuar ndikimin mjedisor. Të jenë të përshtatshëm për lëkurën dhe pëlhurat duke reduktuar rrezikun e acarimit dhe dëmtimit.

Produktet nuk duhet të paraqesin ndonjë rrezik ose duhet të paraqesin vetëm një shkallë minimale rreziku, të pajtueshëm me përdorimin e produktit, që vlerësohet i pranueshëm dhe në përputhje me nivelin e lartë të mbrojtjes e të sigurisë së personave për objektin “Blerje materiale të ndryshme për pastrim” ku përfshihen të gjitha llojet e materialeve të pastrimit.

Të dhënat teknike të përgjithshme të produkteve kanë të përcaktuara karakteristikat e produktit, përshkrimin e produktit, kërkesat cilësore, ambalazhimin dhe etiketimin.

4. LLOJET E MATERIALEVE TË PASTRIMIT

Materialet e pastrimit duhet të kenë cilësi, standarde dhe të ofrojnë pastrim me higjienë të lartë. Produktet e materialeve të pastrimit duhet të jenë sa më ekologjike, pak të dëmshme për ambientet dhe jo alergjike ndaj personave që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me to. Materialet e pastrimit janë produkte të shumëllojshme dhe ka një gamë të gjerë mallrash në treg. Shumë nga këto prodhohen brenda vendit ashtu siç edhe importohen nga jashtë vendit.

Më poshtë janë disa nga produktet të grupuara:

DETERGJENT PASTRUES - *Këto janë detergjent të cilët përdoren për pastrim (larje) të përgjithshëm, si dyshemeje, rrobash, enësh, xhamash, mobiljesh, flokësh dhe duarsh. Detergjentët i ndajmë të lëngshëm dhe të ngurtë.*

Të lëngshëm

- Solucion larës dyshemeje (pllakash)
- Pluhur larës lavatriçe për rroba të bardha
- Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë
- Pluhur larës për rroba larje me dorë
- Solucion larës xhamash
- Solucion larës enësh lëng
- Solucion larës enësh xhel
- Solucion për pastrim të parketit
- Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash
- Solucion larës për mobilje
- Shampo antiparazitare (pedikulocid)
- Shampo parazitësh
- Shampo për larje koke
- Shampo për larje trupi
- Sapun i lëngshëm
- Detergjent i parfumuar
- Detergjent kundër yndyrnave
- Detergjent kundër njollave (sgrasatore)

Të ngurtë

- Sapun rrobash
- Sapun tualeti duarsh
- Detergjent pluhur për makinat larëse

DEZINFEKTANT- *Shërbejnë për pastrim më të thellë dhe më të fortë ndaj papastërtive në sipërfaqe të ndryshme si pajisjet sanitare, pllaka me yndyrë etj. Dezinfektimi kryhet përmes zhytjes, shpëlarjes apo spërkatjes së hapësirave dhe objekteve. Pas pastrimit është e rëndësishme që sipërfaqet të lahen me ujë dhe të vendosen në ambientet larg fëmijëve.*

- Acid për pastrim
- Acid muriatik
- Acid organik pastrues

- Acid pastrues kundër smërçit
- Acid natyror laktik
- Solucion kundra yndyrës
- Solucion larës WC dezinfektues
- Zbardhues rrobash (açe, me përmbajtje hipoklorit natriumi 3-4%)
- Solucion kundra smërçit
- Solucion kundra smërçit për lavatriçe
- Solucion për zhbllokim lavamani
- Solucion për zhbllokim banjo
- Spray kundër pluhurit
- Insekticid për bletë/miza/milingona
- Malathion
- Rodenticid
- K-othrine(ose ekuivalent)
- Solucion mizash dhe mushkonjash (**spray**)
- Alkool etilik 70 %
- Krem antibakterial
- Xhel dezinfektues për duart
- Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%);
- Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%, me përmbajtje klori aktiv **30%-40%**;
- Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%, me përmbajtje klori aktiv **60%-70%**;
- Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%, me përmbajtje klori aktiv **90%**.

AROMATIZUES – *spërkatës për të neutralizuar erën e keqe apo aromat e pakëndshme.*

- Aromatizues zyre
- Aromatizues ambienti për aparatin
- Aromatik tualeti
- Aparat për aromatizues ambienti me kohë sprucimi

FSHESA / SHTUPA / LECKA / FURÇA DHE AKSESORE - *këto janë materiale ndihmëse për pastrim. Përdoren për të tharë dyshemenë pas larjes ose për të fshirë në të thatë pa ngritur pluhur.*

- Fshesë për larje makine
- Fshesë merimangash me shkop
- Fshesë pastrimi pa bisht
- Fshesë pastrimi për ambientet e jashtme (industriale)
- Fshesë me sfungjer dhe gomë për pastrimin e xhamave
- Fshesë për pastrim territori, melakuqi
- Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me fshesë
- Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik
- Karrocë për larje dhe shtrydhje me rrota me mekanizëm
- Shtupë për larje dyshemeje
- Shtupa pambuku për larje dyshemeje
- Shtupa pambuku për larje dyshemeje me veshje plastike
- Shtupë profesionale tharëse për dysheme
- Leckë pastrimi pllakash
- Furçë dhëmbësh

- Furça për lyeje muri me gëlqere
- Furça pastrimi lavamani
- Furça për pastrimin e WC-së
- Furça për larje muri me pllaka
- Furça të vogla të ashpra kirurgjikale
- Furça të vogla për pastrim të imët
- Lecka për larje xhamash me material mikrofibër
- Lopatë plastike për heqje plehrash

PECETA / LETRA

- Kartëpiceta buke
- Peceta pluhrash të thjeshta
- Mbajtëse për letrat
- Letër kasete banjo
- Letër alumini e paketuar në kuti
- Letër duarsh me kuti me sasi
- Letër kuzhine e paketuar
- Letër higjienike e paketuar me rulon
- Letra të lagura higjienike
- Peceta pastrimi mikrofibër

KOSHA / KOVA / LEGENA / GOVATA

- Govatë për bebe
- Kanistër (kosh) plastik për mbajtje medikamentesh
- Kosh grumbullimi për mbetje infektive
- Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave
- Kosh ambienti metalik me kapak
- Kosh plastik i madh
- Karrocë për larje dhe shtrydhje me rrota me mekanizëm
- Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë ovale
- Kovë plastike me shtrydhje
- Shtrydhëse, veçmas kovës (Lecka për pastrim pllakash)
- Kovë e madhe plehrash me pedale për pavion
- Legen plastik
- Legen i vogël plastik
- Enë plastike e vogël me një dorezë (Sapllakë uji e vogël)
- Kosha tualeti me pedale

QESE - *zakonisht përdoret për të futur ushqime, sende të tjera apo për grumbullim materialesh të ndryshme si mbeturina apo veshjet (teshat).*

- Qese mbeturinash
- Qese për mbeturina spitalore infektive
- Qese plastmasi për spitale
- Qese të vogla ushqimore

MATERIALE PËR HIGJENËN PERSONALE - *ku përfshihen artikuj të ndryshëm për higjienë personale:*

- Bakala për pacientin për përdorim urinar
- Pelena për fëmijë
- Pelena për të rritur
- Brisqe
- Brisqe rroje
- Shkumë rroje
- Furçë rroje
- Doreza gome
- Fije qepje
- Gota plastike
- Krehër flokësh
- Qirinj
- Peceta higjenike për përkujdesje intime personale
- Rrjetë për larje trupi
- Sfungjer enësh i thjeshtë
- Sfungjer për pastrim hidrosanitaresh
- Sfungjer për larjen e trupit
- Shkrepëse
- Kruajtëse dhëmbësh
- Tel enësh
- Tel enësh i imët
- Zhbllokues lavamani gome
- Llak kroskoti për makinë
- Pastë dhëmbësh
- Plastmas transparent
- Allçi
- Bombul gazi
- Çizme gome të gjata
- Çizme gome të shkurtra
- Doreza pune
- Gëlqere për lyerje (e gatshme)
- Mbulesë tavoline letër
- Mbulesë tavoline tekstil
- Mbulesë tavoline plastike (mushama).

5. AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Detergjentët klasifikohen e paktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 27/2016 “PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE” dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nën ndikimin e kushteve të jashtme, vetitë e produkteve ndryshojnë. Për të ruajtur cilësinë e tyre, ato ambalazhohen. Ambalazhi mbron nga temperatura, presioni, lagështia, nga ndikimi i insekteve, mikroorganizmave etj. Ambalazhi i zgjedhur mirë, siguron mbrojtje nga çdo ndikim fizik apo mekanik, si dhe nga efektet atmosferike. Por, ambalazhimi kërkohet gjithashtu për të mbrojtur mjedisin njerëzor nga efektet e produktit të ambalazhuar. Ambalazhimi zgjidh problemin kryesor të shitjes, që është mbrojtja e cilësisë së produktit derisa të arrijë te përdoruesi.

Sipas përkufizimit në standardin ISO 8402, sipas të cilit, cilësia është një grup i të gjitha vetive dhe karakteristikave të produktit ose shërbimit që lidhet me aftësinë e tyre për të përmbushur nevojat e përcaktuara ose të shprehura në mënyrë indirekte të përdoruesve.

Mallrat duhet të jenë të ambalazuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në formë të dukshme, në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.
- Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë dhe cilësisë së produktit.
- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshme e të etiketueshme, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.
- Etiketat duhet të jenë qartësisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Të jenë të shkruara rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t’u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.
- Për solucionet “lëng” ambalazhimi / paketimi të jetë në shishe/bidona/kontenier plastike.
- Për solucionet “pluhur” ambalazhimi/ paketimi të jetë në paketim kartoni/ plastik.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit
- Pësia
- Emri i markës prodhuese (emri tregëtar i produktit), adresa e plotë e kompanisë prodhuese dhe/ose tregtuese, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg (kur është e mundur).
- Data e prodhimit për produkte të caktuara, përveç atyre që në logon e paketimit/ ambalazhimit përcaktohet vlefshmëria për periudha 12/ 24/ 36 muaj nga momenti i hapjes për përdorim të produktit.
- Treguesit kryesor fiziko-kimik.
- Specifikimet e kërkuara (përmbajtja, sipas kushteve specifike; informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim).
- Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose e përkthyer në gjuhën shqipe.

6. ARTIKUJT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TYRE

6.1. “BLERJE DETERGJENT,DEZINFEKTANT DHE AROMATIZUES”

1. **Solucion larës dysHEMEJE (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³-1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2. **Pluhur larës për lavatriçe, për rroba të bardha:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Përmbajtja e perboratit të jetë jo më pak se 2 %. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike/kuti kartoni, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Aktiv në të gjitha temperaturat dhe me çdo lloj fortësie uji. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
3. **Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Pluhur me enzima dhe përbërje të avancuar. Përmban sapun, kripa fosfori dhe elementë zbardhës me bazë oksigjeni që japin efekt dhe në ujë të ftohtë dhe temperatura të ulëta. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
4. **Pluhur larës për rroba larje me dorë:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
5. **Solucion larës xhamash:** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.
6. **Solucion larës enësh lëng:** me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10.

Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%.

7. **Solucion larës enësh xhel:** me efekt pastrimi të thellë të yndyrnave. Ambalazhimi në enë plastike me kapak. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e produktit të jetë xhel (në formë paste). Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6.5 deri në 8. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 20% deri në me 35%.
8. **Solucion për pastrim të parketit:** Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%.
9. **Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash:** Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%.
10. **Solucion larës për mobilje:** me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100% në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%.
11. **Shampo antiparazitare (pedikulocid):** Përmban pyrethrin jo më pak se 0.35%, piperonil butoxide jo më pak se 2%. I ambalazhuar në shishe plastike. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
12. **Shampo parazitësh, për larje koke:** të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng i plotë, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH jo më e madhe se 6 dhe jo më e vogël se 5.5. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,025 +/- 0,025 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
13. **Shampo për larje koke:** të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,025 +/- 0,025 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
14. **Shampo për larje trupi:** të ketë aftësi pastruese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 10,000 cp dhe jo më i madh se 15,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,016 +/- 0,005 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
15. **Sapun i lëngshëm:** ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1

- gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 16. Detergjent i parfumuar:** i përshtatshëm për çdo lloj pëlhure, aktiv në të gjitha llojet e papastërtive. Pa përmbajtje fosfate. Nuk ndryshon ngjyrat. Efektiv në të gjitha fortësitë e ujit.
 - 17. Detergjent kundër yndyrnave:** efikas kundër njollave më të forta. Në gjendje të lëngët, kundër yndyrës për të gjitha llojet e rrobave. Efektiv në të gjitha temperaturat e ujit.
 - 18. Detergjent kundër njollave (sgrasatore):** largon pluhurin, vajin dhe ndotësit e tjerë. Me veti zbutëse të papastërtive.
 - 19. Sapun rrobash:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm.
 - 20. Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e vogël se 5 cm.
 - 21. Detergjent pluhur për makinat larëse:** për rrobat e bardha dhe me ngjyrë, pluhur i plotë me fuqi pastrimi optimale. Pa përmbajtje fosfate, tepër efikas në temperatura të ndryshme të ujit.
 - 22. Acid për pastrim:** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
 - 23. Acid muriatik:** përmbajtje acidi klorhidrik 21%. Zbardhës alkaline. Densiteti 1.1-1.4 gram/cm³.
 - 24. Acid organik pastrues:** lëng special për pastrimin e papastërtive kristaline. Lëng transparent, densiteti 1-1.3 kg/l.
 - 25. Acid pastrues kundër smërçit:** detergjent antikalkare me përdorim të shkumëzueshëm, me shkëlqim. Eliminon mbetjet minerale, ndryshk, sapun dhe yndyrna.
 - 26. Acid natyror laktik:** I përshtatshëm për pastrimin dhe dezinfektimin e çdo sipërfaqeje. Prodhuar nga lëndë të para me origjinë bimë. Pa përmbajtje kripëra amoniumi.
 - 27. Solucion kundër yndyrës:** të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.
 - 28. Solucion larës WC dezinfektues:** Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.
 - 29. Zbardhues rrobash (açë me përmbajtje hipoklorit natriumi 3-4%):** Dezinfektant dhe zbardhues cilësor për larjen e rrobave. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen me aromë të lehtë klori. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përbërja e klorit tek

solucioni duhet të jetë nga 3% deri në 4% klor. Densiteti të jetë nga 1.0 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³.

- 30. Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitetet me mekanizëm sprucimi:** Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kriprat e ujit nga hidrosanitetet. Të parandalojë krijimin e kriprave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 31. Solucion për pastrimin e smërçit /kriprave për lavatriçe:** Të jetë masë e pluhurizuar dhe granular për përdorim në lavatriçe. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika në kuti kartoni trajtë pluhuri. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 32. Solucion për zhbllokim lavamani:** me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 33. Solucion për zhbllokim banjo (WC/Pileta):** me efekt zhbllokimi të shpejtë. Ambalazhimi në shishe plastike në trajtë lëngu, ambalazhuar nga fabrika. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene, të ketë aromë të këndshme. Të mos ketë nevojë për tu holluar, në mënyrë që të mos krijojë spërkatje. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 34. Spray kundër pluhurit:** i përshtatshëm për të gjitha sipërfaqet. Parandalon akumulimin e pluhurave, redukton pluhurin në ajër duke e kapur atë në pëlhurë. Fuqi e lartë anti pluhur, me fuqi të lartë absorbuese.
- 35. Insekticid për bletë/miza/milingona:** Insekticid për ambiente të brendshme. Të jetë me aromë jo shumë të fortë. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
- 36. Malathion-Insekticid organofosfat (fosfor organik):** I përdorshëm për ambiente të jashtme.
- 37. Rodenticid:** Deratizues antikoagulant i gjeneratës së dytë. Të jenë efektive ndaj brejtësve që janë rezistentë ndaj antikoagulantëve të gjeneratës së parë. Të përdoret për zhdukjen e brejtësve në shtëpi, objekte publike, objekte industriale, ferma të shtazëve dhe në fusha.
- 38. K-othrine (ose ekuivalent):** Insekticid për të vënë nën kontroll insekte të cilat janë transmetues sëmundjesh në ambiente të brendshme. Të jetë në formë pluhuri me përqendrim të lartë të piretroidit sintetik.
- 39. Solucion mizash dhe mushkonjash:** Spray me ambalazhim në paketim plastik. Të jetë me aromë jo shumë të fortë.
- 40. Aromatizues zyre:** Të jetë me sprucim, i përshtatshëm për ambiente zyre. Neutralizon aromën e ambientit, shpërndan aromë të freskët.
- 41. Aromatizues ambienti për aparatin:** Të jetë statik për tu vendosur në mur në mënyrë të pavarur. Të jetë me aromë të këndshme.
- 42. Aromatik tualeti:** me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e WC-së.
- 43. Krem antibakterial:** Antiseptik me veti dezinfektuese. Eleminon deri në 99.99% të baktereve. Nuk e than lëkurën.
- 44. Xhel dezinfektues për duart:** Dezinfektues për duar me përmbajtje alkooli 70%. Jo irritues për lëkurën.

- 45. Alkool etilik 70%:** antiseptik dhe dezinfektant i përshtatshëm për përdorim të jashtëm, me spektër të gjerë veprimi kundër baktereve, viruseve, majave/kërpudhave. Përdoret për dezinfektim të objekteve të ndryshme, mobilje, pajisje elektroshtëpiake etj.
